



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE “XHAFERR KONGOLI” ELBASAN

Nr. _____ Prot.

Date. 15 .09.2023

PROCESVERBAL - TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “BLERJE PROJEKTI PER RIKONSTRUKSIONIN E
GODINES SE PATHOLOGJISE”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
71335000-5 Studime Inxhinierike**

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,673,221 (gjashte milion e gjashteqind e shtatedhjete e tre mije e dyqind e njezet e nje) leke pa Tvsh Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**“BLERJE PROJEKTI PER RIKONSTRUKSIONIN E GODINES SE
PATHOLOGJISE”**

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) *Formulari i ofertes ekonomike, sipas shtojces 1.*
- b) *Formulari i sigurimit te ofertes, sipas shtojces 3.*
- c) *Formulari permbledhes i vetedeklarimit, sipas shtojces 9.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26 dhe 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojces 9

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël 40% e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra sa vlera e fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 50 dhe 77, pika 3, e LPP, , nenit 54 dhe nenin 43 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe nenit 65, të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe VKM nr. 922, datë 29.12.2014 “ Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 50 dhe 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 54 dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, dhe nenit 104 të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar, si dhe Ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar.

2.2.3 Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022, referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë dhe ku ka zhvilluar apo zhvillon veprimtarinë e tij ,(Sipas ekstraktit të thjeshtë dhe historik të operatori ekonomik lëshuar nga QKB).(Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike ky kriter plotesohet nga secili anetar i bashkimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet ne kerkesat specifike te Ligjit nr 9632 date 30.10.2006 ”Per Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses te nje ose disa kontratave per shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontraten, vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, kontraten e shërbimit, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, ”Per Prokurimin Publik”, ne te cilin gjejme te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në

të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 të nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është përcaktuar se: *“Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: ... Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”*. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nepermjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në piken 4 të nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme **për projektim** të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”*, ndryshuar me *VKM-në nr.943 datë 28.12.2016*”, me kategoritë si më poshtë:

2. PROJEKTUES ARKITEKT

b.3- . Objekte spitalore; terminallet në infrastrukturë; vepra arti në infrastrukturë.

c- Projektim interior

d- Projektim Peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

a- Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

d- Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme murature dhe metalike.

4. PROJEKTUES INSTALATOR

a- Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.

- b- Projektim të instalimeve termoteknike – kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.
- c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
- f- Projektim të sistemeve kundra zjarrit.
- h- Projektimi i impianteve ngritëse e transpor-tuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, etj.)
- j- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile e industriale.

8. PROJEKTUES GJEODET

- a- Rivelime inxhinierike.

10. PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

- e- Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 50 dhe 77 , të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 54 dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në dokumentacionin teknik të dosjes së projektit të zbatimit të objektit të prokurimit si dhe në VKM nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave “Për liçencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Pikat e mesiperme jane vendosur ne baze te punimeve te pritshme te parashikuara qe do te kryen per projektin e godines se Pathologjise se SRE.

2.3.3 Ofertuesi ekonomik duhet te paraqese një listë të stafit kryesor (DrejtuesTeknik ne License te shoqerise) të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë secilin prej tyre, diplomat, kontratat individuale te punes dhe Licencen sipas legjislacionit në fuqi si vijon:

- **1 (nje) Arkitekt**
- **1 (nje) Inxhinier ndërtimi (profil strukturist)**
- **1 (nje) Ixhinier Elektrik**
- **1 (nje) Inxhinier Mekanik**

➤ **1 (nje) inxhinier Gjeodet.**

Për drejtuesit teknik te mesiperm, pika 2.3.3, pjese e stafit te cilet duhet detyrimisht te jene si drejtues teknik te shoqerise te pasqyruar ne listepagesat e shoqerise (ku te figurojne te punesuar me kohe te plote) per tre Muajt e fundit nga data e shpalljese se procedures, duhet të paraqitet kontratë pune (me kohe te plote) me afat vlefshmerie brenda afatit të zbatimit të kontrates për këtë objekt, diplomat dhe licencat perkatese.

Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar staf mbeshtetes si me poshte:

- a. Inxhinier Hidroteknik
- b. Inxhinier Ndërtimi Preventivues;
- c. Ekspert privat zjarrfikës te Certifikuar per Hartimin e Projekteve te Mbrojtjes nga Zjarri.
- d. Ekspert i ndikimit mjedis pajisur me Certifikat per ushtrim profesioni nga Ministria e Mjedisit.

Per stafin e mësipërm operatori ekonomik duhet te paraqesë:

- kontratat e punës;
- diplomat përkatëse;
- Licencat/certifikatat profesionale
- listpagesen e shoqërisë, ku duhet të figurojnë punonjësit si më sipër, për tre muajt e fundit nga data e shpalljes se procedures.

stafi i kerkuar mesiperm duhet të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Argumentimi: Në bazë të nenin 50 dhe pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenit 54 dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Vendorsja e këtij kriteri për stafin teknik është bërë në përputhje me dokumentacionin teknik, termat e referencës dhe natyrën e shërbimeve të kërkuara.

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtoare minimalisht 10 persona për tre Muajt e fundit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të

vetëdeklarimit. operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për tre Muajt e fundit.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për tre Muajt e fundit.

Shënim: Në zbatim të pikës 6, Neni 26, të VKM-së Nr 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dokumentacioni i kërkuar në pikën 2.1/i dhe ii, do të dorëzohet pranë AK, brenda 5 ditëve nga njoftimi për ti dorëzuar por në çdo rast përpara shpalljes së njoftimit të fituesit.

Argumentimi: Në bazë të nenit 50 dhe pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenit 54 dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë: Vendorsja e këtij kriteri për stafin teknik është bërë në përputhje me dokumentacionin teknik, termat e referencës dhe natyrën e shërbimeve të kërkuara .Numri i punonjësve të kërkuar është vendosur në raport me specialistet dhe pajisjet e kërkuara. Ky numër minimal punonjësish është i nevojshëm dhe i domosdoshëm për realizimin e objektit të prokurimit.

2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Total station /gps cope 1 në pronesi ose me qera

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Operatori i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

Per automjetet kur jane ne pronesi te paraqetet çertifikata e pronesise, siguracioni, certifikata e kontrollit teknik. Per automjetet me qera te paraqitet kontrata noteriale e qerese me afat deri ne realizimin e plote te kontrates, siguracioni i automjetit, çertifikata e kontrollit teknik,

Per pajisjet duhet te paraqese fature tatimore te shitblerjes ose kontrate qeraje te noterizuar.

Shënim: Në zbatim të pikës 6, Neni 26, të VKM-së Nr 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dokumentacioni i kërkuar në pikën 2.1/i dhe ii, do të dorëzohet pranë AK, brenda 5 ditëve nga njoftimi për ti dorëzuar por në çdo rast përpara shpalljes së njoftimit të fituesit.

Argumentimi: Në bazë të nenit 50 dhe pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenit 54 dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetete dhe pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Shënim:

Operatorët ekonomikë të interesuar për këtë procedurë prokurimi, në përgatitjen e ofertës së tyre duhet të kenë parasysh përcaktimet e VKM-së Nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” në lidhje me vlerat minimale dhe maksimale, të lejuara, të projektimit.

Vlera e parashikuar e investimit per Rikonstruksionin e Godines se Pathologjise eshte 349,414,300(treqind e dyzet e nente milion e katerqind e katermbedhjete mije e treqind) leke me Tvsh

Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT